

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit B.H., nga fshati Sh., komuna e V., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.142/2016 datë 26.05.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.392/2017 datë 13.10.2017, në seancën e kolegjit e mbajtur më 7 maj 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit B.H. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.142/2016 datë 26.05.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.392/2017 datë 13.10.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.142/2016 datë 26.05.2017, i dënuari B.H. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31.01.2015

e deri më datë 29.05.2015, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.05.2015 e deri më datë 24.07.2015, të cilin dënim i dënuari do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Është obliguar i dënuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €. I dëmtuari N.S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Të dënuarit i është konfiskuar pushka gjysmë automatike e markës “A....AGIS”, e kal.12 bore, me nr.serik....., dhe e njëjta i kthehet autoritetit pyjor në Gj. në shfrytëzim dhe posedim.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.392/2017 të datës 13.10.2017, e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit kurse aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari B.H., për shkak të shkeljeve të ligjit penal dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Prokurori i shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.27/2018 e datës 22.02.2018, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë i dënuari pretendon se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 sepse nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.4 të KPRK-së, sepse aktgjykimi nuk përmban të dhënat e nevojshme nga neni 365 par.1 nënpar.1.1 të KPPRK-së, në arsyetim e aktgjykimit nuk janë paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë fare nuk e ka paraqitur analizën kritike të provave, por kryesisht ka përshkruar përmbajtjen e procesverbaleve të shqyrtimit gjyqësor. Bazuar në dispozitën e nenit 370 par.6 të KPPRK gjykata është e obliguar ti paraqesë arsyet për secilën pikë të aktgjykimit. Sipas dispozitës së par.7 të të njëjtit nen gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara si dhe gjithashtu në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse. Më tej në kërkesë pretendohet se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga

neni 384 par.1 nënpar.12 të KPPK, sepse aktgjykimi është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare e edhe ato që janë paraqitur kanë kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e tij lidhur me përmbajtjen e shkresave të çështjes.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e të dënuarit janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat pretendohen.

Kështu në këtë çështje penalo juridike, dispozitivi i aktgjykimit si dhe aktgjykimi i kundërshtuar në tërësi është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare, të kësaj çështje juridiko-penale, kështu, përshkrimi i dhënë në dispozitiv është i plotë dhe i kuptueshëm, me asgjë të njëjtin nuk e sjell në dyshim. Është bërë përshkrimi i duhur i veprimeve inkriminuese të të dënuarit, por edhe janë dhënë dhe arsyet mbi faktet vendimtare për secilën prej tyre. Në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar janë dhënë arsyet e duhura faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto konkludimet e veta, të cilat si të drejta janë vërtetuar edhe nga shkalla e dytë, e të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Nga shikimi i shkresave të lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar rezultojnë si jo kontestuese faktet se i dënuari B.H. ditën kritike ka qenë në kryerjen e detyrës zyrtare-rojtar pylli në terrenin e fshatit S. I dëmtuari N.S., ditën kritike, në vendin e precizuar në dispozitiv të aktgjykimit, kishte prerë dru në pyllin e pronësisë shoqërore, pikërisht në vendin e quajtur “Z...i V...., pa lejen e autoritetit pyjor dhe të njëjtat i kishte ngarkuar në veturën e tij të tipit “ P...”. Duke u kthyer në shtëpi, rreth orës 14.30 në rrugën K.-V., e ka ndalur rojtari i pyllit, i dënuari B.H., për shkak të dyshimit se ka prerë dru pa autorizim përkatës pasi që i dënuari ndalet dhe del nga vetura biseda në mes tyre kalon në fjalosje. Nuk ishte kontestues as fakti se arma që e kishte në dorë i dënuari

ka shkrepur dy herë dhe me dy predha ishte goditur i dëmtuari me çrast i shkaktohen dëmtime të rënda trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin dhe i dënuari menjëherë pas ngjarjes me veturën e të dëmtuarit të njëjtin e dërgon në Qendrën ambulatore në Viti, pastaj në QS në Gjilan dhe në QKUK në Prishtinë.

Pra, në këtë çështje ishte kontestues fakti **se i dëmtuari a u plagos për shkak të shkrepjes aksidentale të armës**, siç pretendon mbrojtja, **apo i dënuari pas mosmarrëveshjes që kishte me të dëmtuarin ka shtënë në drejtim të tij me qëllim që ta privoi nga jeta**, siç pretendon i dëmtuari.

Nga shkresat e lëndës sipas deponimit të dëmtuarit N.S., është vërtetuar se ditën kritike pasi që është takuar me të dënuarin në pyllin në pronë shoqërore, pas kontrollimit druve që i dëmtuari i kishte në veturë dhe pas fjalosjes në mes të tyre, **i dënuari ia drejton armen të dëmtuarit, e repeton dhe shtënë dy herë në drejtim të tij.**

Sipas shkresave të lëndës dhe aktgjykimeve të kundërshtuara rezultojnë si të vërtetuara rrethanat lidhur me funksionimin e armës së gjuetisë gjysmë automatike e markës “A... AGIS”, e kal 12 bore me nr. serik..., me të cilën është kryer vepra penale dhe nga testet balistike është konstatuar se arma ka funksionuar në mënyrë të rregullte, se arma është e sigurt dhe nuk mund të shkrep vetvetiu sepse sipas karakteristikave që ka është shumë e sigurt, nuk mund të shkrep nëse bien nga krahu ose prej një distance që bien në tokë dhe **vetëm nëse ka gishtin në këmbëz, ajo mund të shkrep.**

Prandaj, nga arsyet e sipërpërmendura të cilat janë dhënë në aktgjykimet e kundërshtuara, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerëson si të drejta konkludimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë se dashja e të dënuarit ka qenë e orientuar në tentimin e privimit nga jeta të dëmtuarit , e jo siç pretendon i dënuari se ngjarja ka ndodhur aksidentalisht, sepse siç u tha edhe më lartë **nga ekspertiza është përjashtuar çdo mundësi që arma me të cilën është kryer vepra penale mund të shkrep në mënyrën si e ka përshkrua i dënuari** , por përkundrazi është armë e tipit të ri dhe shumë e sigurt, ndërsa në anën tjetër fakti se i dënuari pas fjalosjes me të dëmtuarin menjëherë ia drejton armën, e repeton dhe shtënë dy herë në drejtim të dëmtuarit dhe i shkakton të njëjtit lëndime të rënda trupore, fakte këto që padyshim vërtetojnë edhe dashjen e të dënuarit për ta kryer veprën penale. Prandaj ,të gjitha ato që janë thënë në arsyetimin e aktgjykimimit të

kundërshtuar përkitazi me vlerësimin e mbrojtjes së të dënuarit si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Prandaj, në bazë të paraqiturave më lartë, rezulton se në veprimet inkriminuese të të dënuarit B.H., përmbushen të gjitha elementet e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPPK-së, dhe nga rrethanat e sipërpërmendura, të pabazuara janë pretendimet e të dënuarit se është bërë shkelja e ligjit penal në dëm të tij sepse veprimet e tij përmbajnë elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkeljen e ligjit penal dhe shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat në kërkesë pretendohen dhe në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.41/2018, më datë 07.05.2018

Procesmbajtëse,
Minire Xhambazi

Kryetarja e kolegjit,
Emine Mustafa